



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi Nr. 25 /2021
Data: 20.05.2021

Duke u bazuar në nenin 28, 29 dhe çështjet procedurale të përcaktuara sipas Nenit 13,15,17,18,19,20,35,50 dhe 54 par 1.3 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe Neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 20.05.2021, mori këtë;

V E N D I M

- I. LEJOHET**, Përqendrimi i NOMAD FOODS EUROPE LIMITED (Blerësi), kompani e inkuorporuar në Angli dhe Uells më numër të kompanisë 05879466, e regjistruar në 1, New Square, Bedfont Lakes Business Park, Feltham, Middlesex, Angli TW148HA, me aktivitet shitja dhe prodhimi i ushqimeve të ngrira në Europë dhe tregun botëror dhe/ Mbi FORTENOVA GRUPA D.D,d.d; - kompani aksionare e themeluar në Kroaci, më seli të regjistruar në Marijana Čaviča 1,10000, Zagreb, Kroaci, regjistruar nga Regjistrin Gjyqësorë të Gjykatës Komerciale, Zagreb më Nr. (MBS) 081179147, Nr. Identifikimi personal (OIB) 88035992407, Aktivitetet kryesore të FORTENOVA GRUPA D,D,d.d (shitës bazuar në ekstraktin nga regjistri përkatës tregtar i kompanive, janë si më poshtë: administrimi i ndërmarrjeve dhe veprimi si kompani Holding (mbajtës), dhe është prezentë në Kosovë përmes filialit **Ledo sh.p.k** ("**Ledo KOS**") me adresë në Obiliq, Milloshevë, Kosovë me Nr. të regjistrimit 810385668 me aktivitet, shitja e akullloreve dhe ushqimet e ngrira. Kompania e vetme nga Kompanitë e Gupit të Targetuar që është e inkuorporuar ose e regjistruar në Kosovë "**Ledo KOS**" aktualisht është 100% në pronësi të drejtpërdrejtë si filial i FORTENOVA GRUPA D.D, d.d.
- II.** Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tre mijë euro).

ARSYETIM

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (tutje ref. "Autoriteti"), me datë 02.04.2021, ka pranuar "Kërkesë për Përqendrim", më Nr.Prot:135/21-01/H, nga zyra e avokatisë Kalo & Associates, adresa Rr. Mujo Ulqinaku, 5/1,10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me autorizim të palëve në përqendrim, si në vijim "NOMAD FOODS EUROPE LIMITED," dhe/mbi FORTENOVA GRUPA D.D,dd, - përmes Marrëveshjes së lidhur, më datë 29.03.2021 .

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i dosjes së Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 20.04.2021.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së, me datë 20.04.2021,
4. Vlerësimi dhe analizimi i çështjeve të konkurrencës në transaksionin e propozuar

Andaj, nga sa më sipër (si në "Dispozitiv"), sekretariati i Autoritetit ka bërë vlerësimin e Kërkesës për Përqendrim.

Baza Ligjore dhe Akti i Përqendrimit dhe Struktura e Transaksionit - duke u bazuar në nenit 15, të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezentuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, e kalon shumë 20 milion euro,
2. Targeti, përkatësisht FORTENOVA GRUPA D.D,d.d (shoqëri Holding) dhe ka aksione të regjistruara në Republikën e Kosovës, përmes filialit **Ledo sh.p.k ("Ledo KOS")** me adresë në Obiliq, Milloshevë, Kosovë, Nr.të regjistrimit 810385668, me aktivitet, shitja e akulloreve dhe ushqimeve të ngrira
3. Me datë 29.03.2021, ndërmarrjet FORTENOVA GRUPA D.D,d.d dhe NOMAD FOODS EUROPE LIMITED kanë nënshkruar Marrëveshjen (kontrata) për shitblerjen e aksioneve, për shitjen dhe transferimin e aksioneve të biznesit tek NOMAD FOODS EUROPE LIMITED, objekt i "Marrëveshjes" është shitja e 100% e aksioneve (pronësisë) nga shitësit FORTENOVA GRUPA D.D, d.d.,

Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu Relevant

Tregu i Produktit - përfshin, prodhimin, furnizimin më shumicë i akullores, po ashtu edhe prodhimin, furnizimin më shumicë të ushqimeve të ngrira në Kosovë. Shitja e ushqimit të ngrirë përfshin kategoritë: mish të përpunuar, të ngrirë, prodhime deti të përpunura të

